

QYTETI I SHKUPIT

Propozues: Kryetari i Qytetit të Shkupit

Përpilues: Sektori për zhvillim ekonomik
lokal

Përfaqësues: Sllobodan Qosev,
drejtues i Sektorit për zhvillim
ekonomik lokal

Përkrahje : SNV-Organizatë holandeze për
zhvillim

PROPOZIM - PLAN AKSIONAL

*për realizimin Strategjisë për zhvillimin ekonomik
lokal të Qytetit të Shkupit për
periudhën 2006-2009*

Shkup, shtator 2007

Propozim

Në bazë nenit 36 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM" numër 5/02) dhe nenit 10 paragrafi 1 pika 3 alinea 1 nga Ligji për Qytetin e Shkupit ("Gazeta zyrtare e RM " numër 55/04), Këshilli i Qytetit të Shkupit në seancën e _____, të mbajtur më _____ 2007 solli

PLAN AKSIONAL

për realizimin e Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal
të Qytetit të Shkupit për periudhën 2006-2009

HYRJE

Plani aksional është pjesë përbërëse e Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal të Qytetit të Shkupit për periudhën 2006-2009, e sjellë nga Këshilli i Qytetit të Shkupit, në dhjetor 2006.

Ky dokument është vazhdim i aktiviteteve për realizimin e qëllimeve strategjike për zhvillimin e qytetit, të definuara me Strategjinë ekzistuese për ZHEL të Qytetit të Shkupit.

Aktivitetet e ndërmara me këtë projekt ishin përcaktuar nga procesi i decentralizimit në të cilin planifikimi ekonomik lokal përbën një kompetent të domosdoshëm dhe sfidën më të madhe me të cilën përballen njësitë e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë, si kompetencë e ndarë dhe obligim për njësitë e vetëqeverisjes lokale.

STRUKTURA E PALNIT AKSIONAL

Plani aksional 2006-2009 është përgatitur në bazë të shtatë qëllimeve profesionale, Vizioni dhe Misioni, të definuara në Strategjinë për zhvillim ekonomik lokal dhe mjetet e nevojshme për realizimin e tyre.

A) VIZION

Realizimi i qëllimeve strategjike duhet të kontribuojë për realizimin e **VIZIONIT për Qytetin e Shkupit** e cila thotë:

- *Qytet në të cilin qytetarët do të kënaqen me kualitetin dhe standartin e jetës urbane.*
- *Qytet i përgatitur t'i shfrytëzojë praktikatat më të mira botërore, të përmirësojë dhe përparojë rrethimin ekonomik, të investojë në qytetarët-veçanërisht në të rinjtë me qëllim sigurimin e prosperitetit të bashkësisë.*
- *Qytet-promotor i biznesit, industrisë investuese dhe kreative, qendër për shërbime financiare dhe jo financiare.*

B) MISION

Misioni për vetëqeverisjen lokale për realizimin e këtij Vizioni është:

Përkushtim ndaj arritjeve dhe kreimit të nevojave për zhvillim ekonomik lokal të përshpejtuar të Qytetit të Shkupit nëpërmjet;

- *Përfshirjen e organeve të vetëqeverisjes lokale, ndërmarjeve publike, institucioneve publike, sektorit privat dhe qytetar, sektorit joqeveritar dhe bashkësisë ndërkombëtare dhe*
- *Trajnim në kontinuitet dhe përgatitje e organeve të vetëqeverisjes lokale, të ndërmarjeve publike dhe institucioneve publike për shërbime të standartizuara me kualitet të lartë dhe të orientuar kah biznesi dhe qytetarët.*

C) QËLLIME STRATEGJIKE

Qëllimet strategjike që duhet të realizohen me zbatimin e Planit aksional kanë të bëjnë me shtatë segmente kryesorë nga zhvillimi ekonomik lokal dhe atë: kualitet dhe standart i jetës, biznese dhe investime, aftësimi për punë, përkrahje e kreativitetit, promovim i potencialeve, nxitja e konkurrencës, përkrahje e shërbimeve financiare dhe jofinanciare.

Realizimi i qëllimeve strategjike është i lidhur me realizimin e projekteve të parashikuara (gjithsej 91)

Në vazhdim është dhënë çdo qëllim strategjik me numrin e projekteve/aktiviteteve dhe rezultatet që duhet të arrihen

C.1. Sigurim i kualitetit të lartë dhe standarti jetësor të qytetarëve dhe ambient tërheqës për bizneset, banorët dhe turistët, 22 projekte/aktivitete

Projekte/ Aktivitete

1. Treg i organizuar në komunën Gazi Baba për tregëti me pakicë të automjeteve motorike të përdorura.
2. Treg i organizuar me pakicë në komunën Shuto Orizari
3. Treg i organizuar në komunën Çair me pakicë me dru të përpunuar, material ndërtimi të përpunuar, makineri dhe vegla për përgatitjen e materialeve të ndërtimit
4. Definimi i ofertës në pjesën e monumenteve natyrale, arkeologjike dhe kulturore
5. Promovim i kalasë së Shkupit me qëllim transformimin e saj si atraksion kulturor, afarist dhe turistik i qytetit
6. Promovim turistik i objekteve speleontologjike – shpellat Ubava dhe Vrelo
7. Lokalitet alpinistik Matka –rregullim i drejtimeve alpinistike dhe vendosja e pikave bashkëkohore siguroese dhe tabela informative
8. Revitalizim i Akuaduktit si monument kulturor-historik dhe afirmimin e tij
9. Përmirësimi i parkut të automjeteve të NTP Shkup me furnizimin me autobusë ekologjikë.
10. Zgjerimi i ofertës turistike në regjionin e Qytetit të Shkupit
11. Инфо kioskë me informacione për ofertën kulturore dhe turistike të qytetit
12. Revitalizimi i Çarshisë së vjetër të Shkupit
13. Promovimi i turizmit të manstarive
14. SIGJ për Shkupin dhe Komunat dhe kadastër nëntokësor
15. Energji ripërtëritëse-sistem i ndriçimit rrugor në OGB i gjeneruar me energjinë diellore
16. Qendër rekreative sportive Gazi Baba – dokumentacion investues
17. Qendër rekreative sportive Hipodrom
18. Revitalizimi i liqenit Treska
19. Banesa sociale
20. Ndërtim parks (sipas modelit të parkut të qytetit) në pjesën rurale të komunës, me vendosjen e përmbajtjeve argëtuese rekreative
21. Definimi i përkrahjeve për zhvillimin e turizmit të fshatit (infrastrukturë, lloje teknikash dhe përkrahje financiare)
22. Realizimi i studimit fizibiliteti për ujitjen e sipërfaqeve të gjelbra me puse nëntokësorë

Rezultate

- Tregje me pakicë të organizuar
- Fushatë promotive e realizuar, ofertë e zgjeruar turistike të Qytetit të Shkupit dhe Info kioskë të vendosura
- Lokalitete të revitalizuar Matka dhe Akuadukti
- Park automjetesh i përmirësuar me EKO EU Standarte
- Sistem për komunikim me qytetatrët dhe procedurë për legalizimin e bizneseve
- SIGJ i përgatitur me kadastër nëntokësor
- Qendra rekreative sportive të ndërtuar dhe revitalizimi i liqenit Treska
- Sistem hyrës për menaxhimin me mbeturinat dhe 3 oborre për reciklim
- Banesa sociale të ndërtuara

C.2. Promovimi i bizneseve të reja dhe investime, 26 projekte/aktivitete

Projekte/ Aktivitete

1. Mini treg me pakicë
2. Industri e lehtë jo ndotëse gjatë unazës
3. Zonë e re e pandotur
4. KRC, kompleks turistik- Tri krushi
5. Industri e lehtë jo ndotëse - DUP
6. AKUA PARK - Liqeni Treska
7. Lokacione të pastra për investitorë vendas dhe të huaj
8. Tregu i luleve
9. Vendosja e trajtimit të mbeturinave komunale, me formimin e partneritetit publiko-privat
10. Dokumentacioni tramvaj
11. Gasifikim, pajisje ekologjike për transport publik
12. Ndërtim i qendrës rekreative sportive
13. Futja e zonës për ekonomi të vogël-Momin potok
14. VID zona Leptokarija
15. Zonë për industrinë automobilistike
16. Projekt Aleksandrija
17. Lokacione dhe përkrahje për prodhimin e ushqimit të shëndetshëm

18. Zonë e lirë ekonomike
19. Biznis improvement building me seli në Komunën Gazi Baba
20. Garazh me kate
21. Zona ekonomike kazerna Ilinden
22. Garazh nëntokësor, Shtëpia e mallrave Ilinden
23. Zonë e padoguanuar OHIS
24. Prodhim oranzherik i luleve
25. Zona për ekonomi të vogël Koridori 8
26. Nxitje dhe përkrahje për regjistrimin e mikro bizneseve të peregjistruara

Rezultate

- Mini pazar i ndërtuar
- Zona industriale të rregulluara, lokacione të ndara dhe legalizim i mikro bizneseve
- Akua park i rregulluar në liqenin Treska
- Lokacione të rregulluara për investitorë, të vendosur në portal dhe të shpallura në katalog
- Kompleks i rregulluar Tri Krushi dhe lokacione të ndara
- Treg lulesh i ndërtuar
- Liqeni Treska i rregulluar dhe revitalizuar
- Zona të rregulluara për MSP, industri automobilistike
- Investime në shërbime publike dhe partneritete privato-publike të ndërtuara
- Garazhe nëntokësore dhe me kate

C.3. Shfrytëzmi i praktikave më të mira botërore dhe investime në qytetarët-veçanërisht të rinjtë, 20 projekte/aktivitete

Projekte/ Aktivitete

1. Poligon i qendrave për trajnimin në artizanat
2. Fond qytetar për përkrahje
3. Trening evropian/Qendra e kongreseve
4. Ndërmjetësim gjatë punësimit të të rinjve me arsim të lartë të papunësuar
5. Trajnim i kuadrit për përgatitje dhe implementim të projekteve

6. Zhvillimi i artizanatit, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (program për zhvillim, edukim i sipërmarrjes)
7. Organizimi i Forumit të shoqatave qytetare
8. Përpilim regjistri për shoqatat e qytetarëve
9. Përpilimi i bazave të të dhënave për projekte të cilat realizohen në partneritet me sektorin joqeveritar
10. Strategji për bashkëpunim dhe përkrahje të qytetarëve dhe Fondacioneve
11. Vendosja e sistemit të nominuar, realizim, evaluim dhe monitoring i projekteve në partneritet me sektorin joqeveritar
12. Definimi i sistemit të koordinimit të aktiviteteve që i ndërmerr Qyteti i Shkupit me shoqatat e qytetarëve
13. Fuqizimi i rolit konsultativ në OJQ në procesin e kreimit të politikave dhe fuqizimi i besimit në sektorin joqeveritar
14. Ndërtimi i partneriteteve afatgjata për shoqata të qytetarëve dhe fondacione me interes për Qytetin e Shkupit
15. Përkrahje e trajnimeve për qytetarët për shfrytëzimin e mjeteve moderne telekomunikuese dhe internetit
16. Shfrytëzimi i resurseve të OJQ nga ana e vetëqeverisjes lokale gjatë zhvillimit të dokumenteve strategjike
17. Themelimi i Fondit për zhvillimin e resurseve njerëzore
18. Trajnim dhe aftësim i punëtorëve turistikë për promovimin e potencialit turistik
19. Zhvillim i mekanizmave për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e sjelljes së vendimeve të vetëqeverisjes lokale dhe zbatimi në kontinuitet i tyre
20. Promovim dhe ngritje e vetëdijes publike për selektimin dhe reciklimin e mbeturinave

Rezultate

- Poligon i ndërtuar, 3 programe të dizajnuara për trajnim, 100 të trajnuar, 50 MSP të reja
- Sistem i instaluar për menaxhimin me mbeturinat
- Partneritet strategjik të ndërtuar me sektorin OJQ
- Program i sjellur për trajnim në kontinuitet të kuadrit
- Trajnim evropian /Qendër e kongreseve
- Fushata publike, edukative dhe promotive
-

C.4. Afirmim dhe përkrahje e industrive kreative, 2 projekte/aktivitete

Projekte/ Aktivitete

1. Festival i zejtarëve
2. Formim i ART BAZAR në Shtëpinë e zejtarëve

Rezultate

- Festival i mbajtur i zejtarëve
- ART Bazar i formuar

C.5. Promovim i Qytetit të Shkupit si qendër regionale për zhvillimin e biznesit, 5 projekte/aktivitete

Projekte/ Aktivitete

1. Formim i Biznes forumit
2. Promovim i qytetit si partner në projekte ndërkombëtare
3. Promovim i ofertës turistike para subjekteve relevante vendase dhe ndërkombëtare në turizëm
4. Promovim i lokacioneve të planifikuara-udhëheqës për investitorë
5. Studim për turizëm alternativ-fshati, gjah, sporte kalëruese etj

Rezultate

- Biznes Forum i formuar
- Programe të sjella për promovimin e Qytetit të Shkupit në projekte ndërkombëtare
- Pjesëmarrje në panaire dhe manifestime ndërkombëtare
- Udhëheqës për investitorë i përgatitur
- Studim i përgatitur për turizëm-fshati, gjah, sporte kalëruese, korsi

C.6. Zhvillimi i ekonomisë konkurente

Projekte/ Aktivitete

1. Kolektor diellor
2. Park teknologjik/inkubatorë
3. Pjesëmarrje e përbashkët me sektorin e biznesit në panaire vendase dhe ndërkombëtare dhe forume
4. Çmim vjetor për ofertën më të mirë turistike
5. Çmim vjetor për eksportuesin më të mirë
6. Mini treg dhe veprimtari shërbyese
7. Dokumentacion për energji alternative dhe gazifikim

Rezultate

- Kolektor diellor i ndërtuar
- Park teknologjik i formuar/ Inkubator
- Pjesëmarrje në panaire dhe biznes forume
- Çmime të ndara për ofertën më të mirë turistike dhe eksportuese
- Tregje të hapura për veprimtari shërbyese
- Dokumentacion për energji alternative dhe gazifikim

C.7. Zhvillim si qendër për shërbime financiare dhe jofinanciare 9 projekte dhe aktivitete

Projekte/ Aktivitete

1. Definimi i lokacioneve dhe llojeve të përkrahjeve për zhvillimin e sektorit financiar, bankar dhe tercial i mbetur
2. Definimi i sistemit të kreditimit të trajnimit të qytetarëve
3. përgatitja e rejtingut kreditor si parakusht për investime
4. Program për masa për realizimin e përkrahjes financiare të shoqatave të qytetarëve me interes për Qytetin e Shkupit
5. Formimi i fondeve të qytetit për zhvillimin e ekonomisë (me fokus të qëndrueshmërisë së bujqësisë, ekonomi të vogla me alternativa, veprimtari shërbyes dhe të tjera) dhe zhvillim i turizmit të qytetit dhe ekologjik
6. Formim i punktut donues informativo-qytetar (bazë të dhënash për të gjithë donatorët)
7. Lidhje e qendrave të komunave për punësim me Kancelarinë për zhvillim ekonomik lokal – ZHEL të Qytetit të Shkupit
8. Definimi i llojeve të përkrahjeve për zhvilimin e turizmit të fshatit (infrastrukturë, lloje teknikash dhe përkrahje financiare)
9. Themelimi i qendrës së komunës për përkrahje të artizanatit dhe bujqësisë

Rezultate

- Definimi i lokacioneve për sektorin financiar
- Program i sjellë për kreditim të trajnimeve të qytetarëve
- Rejting kreditor i përgatitur
- Fonde të formuara për përkrahjen e bizneseve, bujqësisë dhe turizmit

- Definimi i Programit për masa të përkrahjes dhe formimit të Fondeve qytetare

Ç) PARTNERITETE

Ndërtimi i partneriteteve për realizimin e projekteve dhe realizimi qëllimeve strategjike të Planit aksional planifikohet të zhvillohet në disa nivele:

- Bashkëpunim me pushtetin qendror (Qeveri dhe ministri) për sigurimin e hapësirës (tokë ndërtimore dhe lokacione) tërheqja e investitorëve dhe promovimi i potencialeve ekonomike dhe turistike
- Bashkëpunim me komnatat e Qytetit të Shkupit dhe ndërmarjet publike për sigurimin e infrastrukturës së nevojshme, kuadro dhe sisteme menaxhimi me qëllim krijimin e rrethimit afarist që rrit efikasitetin në realizimin e biznesit.
- Bashkëpunim me OJQ dhe sektorin e biznesit për promovimin e aktiviteteve të ndërmarra dhe zmadhimin e përfshirjes së shfrytëzuesve të rezultateve të projekteve.
- Bashkëpunim me donatorët dhe investuesit për sigurimin e burimeve cilësore të financimit dhe krijimit të një shkalle solide të qëndrueshmërisë të rezultateve të projekteve.

D) PROJEKTE DHE AKTIVITETE

Aktivitetet projektuese të planifikuara me planin aksional janë paraqitur në excel dokument i cili është pjesë përbërëse e Planit aksional. Në të janë përmbledhur vizioni, qëllimi strategjik, rezultate, indikatorë, partneritet, projekte-aktivitete, subjekte përgjegjëse, kornizë kohore, burime financimi dhe inputet e nevojshme për realizimin e tyre.

Për realizimin e Planit aksional të propozuar janë të nevojshme këto inpute (elemente hyrëse): kuadër profesional për përgatitjen e dokumentacionit projektues, lokacione infrastrukturore të pastruara, të rregulluara, informacione, teknologji dhe udhëheqje me projektet.

DH) PARASHIKIME BUXHETORE

Mjetet financiare të parashikuara për realizimin e Planit aksional janë 64.472.000 Euro. Sigurimi i tyre planifikohet nga këto burime: Sigurimi i tyre planifikohet nga këto burime: 6% nga Qyteti i Shkupit, 8% nga komnatat e Shkupit, 34% nga donatorë dhe 52 % nga burime të tjera.

Rekapitulari i buxhetit tregon mjetet financiare të nevojshme për realizimin e çdo qëllimi strategjik në veçanti:

<i>N.r.</i>	<i>Qëllimi strategjik</i>	<i>Vlera në euro</i>
1.	Sigurimi i kualitetit të lartë jetësor të qytetarëve dhe ambient tërheqës për bizneset, banorët dhe turistët (22 projekte/aktivite)	17.540.000,00
2.	Promovim i bizneseve dhe investimeve, (26 projekte/aktivite)	42.301.000,00
3.	Shfrytëzimi i praktikeve më të mira botërore dhe investim në qytetarët-veçanërisht në të rinjtë, (20 projekte/aktivite)	2.324.500,00
4.	Afirmim dhe përkrahje e industrive kreative, (2 projekte/aktivite)	415.000,00
5.	Promovim i Qytetit të Shkupit si qendër regjionale për zhvillimin e bizneseve, (5 projekte/aktivite)	620.000,00
6.	Zhvillim i ekonomisë konkurente (7 projekte/aktivite)	570.500,00
7.	Zhvillim si qendër shërbime finacuese dhe jofinacuese, (9 projekte/aktivite)	701.000,00
	GJITHSEJ:	64.472.000,00

E) IMPLEMENTIM DHE MONITORING

Gjatë procedurës për përgatitjen dhe sjelljen e planit aksional definohet procedura për propozimin dhe miratimin e ideve për projekte. Gjithashtu u përgatit edhe model për formularë për përgatitjen e çdo ideje projektues në veçanti.

Pas sjelljes së Planit aksional implementimi i projekteve dhe aktiviteteve të pranuar do të zhvillohen sipas këtyre hapave:

1. Arsyetim i shkurtër i projektit në përputhje me formularin “Përshkrim i idesë projektuese”,
2. Përgatitja e projektit sipas modeleve për planifikimin e projektit.
3. Përgatitje për dokumentacionin projektues për financimin e projektit.
4. Aplikim dhe udhëheqje e bisedimeve me donatorë dhe investitorë për pjesëmarrje në financimin e projektit.
5. Mobilizimi i sektorit qytetar dhe biznesit për përkrahje dhe përfshirjen e tyre në projekt.

Për monitoringun e implementimit të Planit aksional është e nevojshme të formohet trup pune për ndjekjen e planit aksional për realizimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal të Qytetit të Shkupit për periudhën 2006-2009. Në të duhet të

participojnë përfaqësues të palëve të interesuara. Përkrahje në punën e trupit punues duhet të sigurojë Sektori për zhvillim ekonomik lokal të Qytetit të Shkupit.

**PLAN DETAJUES AKSIONAL
PËR REALIZIMIN E QËLLIMEVE STRATEGJIKE
PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK LOKAL TË QYTETIT TË SHKUPIT
2006-2009**

Për realizimin e çdo qëllimi strategjik janë definuar aktivitete të veçanta dhe janë përgatitur shumica e ideve për projekte.

Në Planin detajues aksional është paraqitur korniza kohore dhe burimet e financimit (buxheti) për realizimin e çdo qëllimi strategjik dhe për për çdo projekt-aktivitet në veçanti, personat/sectorët përgjegjës, si dhe resurset e nevojshme për realizimin e tyre.

Si shtojcë janë dhënë përshkrime të ideve projektuese për 43 dhe 91 aktivitete projektuese të shpërndara sipas qëllimeve strategjike.

Në përputhje me dinamikën e implementimit të Planit detajues aksional do të përgatiten përshkrime të ideve projektuese edhe për projektet/aktivitetet e planifikuara dhe të njëjtat do t'i bashkangjiten Planit aksional.

VIZION: Qytet në të cilin do të kënaqen me kualitetin e lartë dhe standartin e jetës urbane. Qytet i gatshëm t'i shfrytëzojë praktikrat më të mira botërore, ta përmirësojë rrethimin ekonomik, të investojë në qytetarët-veçanërisht në të rinjtë me qëllim sigurimin e prosperitetit të bashkësisë. Qytet-promotor i biznesit, investimet dhe industrinë kreative, qendër për shërbime financiare dhe jofinanciare										
Qëllimi strategjik 1. Sigurim i kualitetit dhe standartit të jetesës së qytetarëve dhe ambient tërheqës për bizneset, banorët dhe turistët										
Rezultate					Indikatorë					
1. Tregje të organizuara me pakicë					1. Hapësirë e përfshirë xa					
2. Fushatë promotive e realizuar, ofertë turistike e zgjeruar e Qytetit të Shkupit kioskë të vendosur					2. Numri i turistëve					
3. Lokalitete të revitalizuara Matka dhe Akuadukti					3. Numri i MСП të reja					
4. Park automjesh i përmirësuar EKO EU Standarte					4. Kursime të Buxhetit					
5. Sistem për komunikim me qytetarët dhe procedurë për legalizimin e bizneseve					5. Hapësirë e përfshirë xa dhe sasi e mbeturinave të mbledhura					
6. GIS i përgatitur dhe kadastër nëntokësor					6. Numri i qytetarëve të përfshirë					
7. Qendra rekreative sportive e ndërtuar dhe liqeni Treska i revitalizuar										
8. Sistem hyrës për menaxhimin me mbeturinat dhe 3 oborre për reciklim										
9. Banesa sociale të ndërtuara										
Strategji për partneritet: Qeveri, ministri, Qyteti i Shkupit, komuna, sektori i biznesit (privat), partneritet publik privat										
Aktivitet/Projekte	Përgjegjës - Person/ Organ dhe/ose Partner/	Kornizë kohore		Burime të financimit të buxhetit në (euro)					Inpote/ informate/ njerëz, teknologji/ resurse	
		Fillim	Kohë zgjatje	Qyteti i Shkupit	Komuna	Donatorë	Bur. të tjera financ.(kredite, letra me vlerë.)	Buxhet gjithsej		
1.1.	Treg i organizuar në Gazi Baba për tregëti me pakicë të automjeteve të përdorura	Komuna Gazi Baba, Qyteti i Shkupit	2007.	2008.	4.000	16.000			20.000	pajisje, njerëz , financa

1.2.	Treg i organizuar me pakicë në Komunën Shuto Orizari	Komuna Shuto Orizari, Qyteti i Shkupit	2007	2008	4.000	16.000			20.000	pajisje, njerëz , financa
1.3.	Treg i organizuar në Komunën Çair për tregëti me pakicë me dru të përpunuar, mater. ndërt. i gdhendur, makineri dhe vegla për përpunim e mat. të ndërt.	Komuna Çair, Qyteti i Shkupit	2007	2008	4.000	16.000			20.000	pajisje, njerëz , financa
1.4.	Definimi i ofertës në pjesën e të ardhurave, monumenteve arkeologjike dhe kulturore	Seksioni për turizëm ZHEL/ Qyteti i Shkupit dhe Komuna Gj. Petrov	2007	2009		9.000	21.000		30.000	pajisje, njerëz , financa
1.5.	Promovimi i kalasë së Shkupit me qëllim transformimin e saj në atraksion kulturor, afarist dhe turistik	Seksioni për turizëm ZHEL/ Qyteti i Shkupit	2007	2009	5.000		5.000	5.000	15.000	ekspertë, informacione, njerëz
1.6.	Promovim turistik i objekteve speleontologjike-shpellat Ubava dhe Vrelo	Seksioni për turizëm ZHEL/ Qyteti i Shkupit	2007	2009	5.000		20.000		25.000	ekspertë, informacione, njerëz, financa
1.7.	Lokaliteti alpinistik Matke-rregullimi i drejttimeve alpinistike dhe vendosja e pikave siguroese bashkëkohore dhe tabela informative	Seksioni për turizëm ZHEL/ Qyteti i Shkupit	2007	2009	50.000	5.000	50.000	20.000	125.000	ekspertë, informacione, njerëz, financa
1.8.	Revitalizimi i Akuaduktit si monument kulturor-historik dhe afirmim i tij	Seksioni për turizëm ZHEL/ Qyteti i Shkupit Kom. Butel	2007	2009	20.000	50.000	1.000.000	1.000.000	2.070.000	

1.9.	Rinovimi i parkut të automjeteve të NTP Shkup me furnizimin me autobusë ekologjik të rinj.	Sektori komunikacionit/ Qyteti i Shkupit	2007	2009	500.000			2.500.000	3.000.000	pajisje, njerëz , financa
1.10.	Zgjerimi i ofertës turistike në territorin e Qytetit të Shkupit	Seksioni për turizëm ZHEL/ Qyteti i Shkupit	2007	2009	10.000		10.000		20.000	ekspertë, informacione, njerëz,
1.11.	Info kioskë me informacione për ofertën kulturore turistike të qytetit	Sektori ZHEL/Qyteti i Shkupit	2008	2009	25.000		75.000,00	25.000,00	125.000,00	
1.12.	Revitalizimi i Çarshisë vjetër të Shkupit	Oda e artizanatit, Qyteti i Shkupit, K. Çair	2007	2008	100.000		400.000	500.000	1.000.000	
1.13.	Promovim i turizmit të manastireve	Sektori ZHEL/Qyteti i Shkupit, Komuna Butel	2007	2009	5.000		25.000		30.000	
1.14.	SIGJ për Shkupin dhe komunat dhe kadastër nëntokësor	Komuna/ Qyteti i Shkupit	2007	2009	1.000.000	100.000	400.000		1.500.000	
1.15.	Energji ripërtësitëse-sistem i ndriçimit rrugor në OGB i generuar me enrgji diellore	Komuna Gazi Baba	2008	2009		15.000	20.000		35.000	
1.16.	Qendra rekreative sportive Gazi Baba-Dokumentacion investues	Komuna gazi Baba/Kom. Çair	2007	2009		50.000	200.000		250.000	
1.17.	Qendra rekreative sportive Hipodrom	Komuna Gazi Baba	2007	2009		50.000	200.000		250.000	
1.18.	Revitalizimi liqenit Treska	Komuna Saraj/NP dhe Qyteti i Shkupit	2008	2010	150.000	50.000		2.000.000	2.200.000	
1.19.	Banesa sociale-	Shuto Orizar	2007	2009		5.000	3.000.000	1.500.000	4.505.000	

1.20.	Ndërtim parku (sipas modelit të parkut të qytetit) në pjesën rurale komunës, me vendosjen e përmbajtjeve zbavitëse rekreative	Aerodrom	2008	2009		100.000	400.000		500.000	
1.21.	Definimi i llojeve të përkrahjeve për zhvillimin e turizmit të fshatit (infrastrukturë, lloje teknikash, përkrahje financiare)	Spektori ZHEL/Qyteti i Shkupit, Комуна Gjoçe Petrov	2007	2009	45.000	30.000	225.000		300.000	
1.22.	Realizimi i studimit fizibilitet për ujitjen e sipërfaqeve të gjelbra me bunarë nëntokësorë	NP Ujësjellës dhe kanalizim	2008	2009	150.000		1.200.000	150.000	1.500.000	
GJITHSEJ					2.077.000	512.000	7.251.000	7.700.000	17.540.000	
					11,84%	2,92%	41,34%	44%	100%	

PËRSHKRIM i idesë projektuese

Projekti nr: 1.1	Sfera: tregëti Qëllimi strategjik: Sigurim i kulaitetit dhe standartit të lartë të jetesës së qytetarëve dhe ambient tërheqës për bizneset, banorët dhe turistët
Projekti: Treg i organizuar në komunën Gazi Baba për tregëti me pakicë të automjeteve motorike të përdorura	
Përshkrim i shkurtër i projektit: Meqenëse në terrtorin e komunës Gazi Baba frekuenca e qytetarëve është e madhe, që këtu del nevoja e një tregu të tillë komunal të rregulluar dhe specializuar. Bëhet fjalë për treg komunal të specializuar për automjete motorike të përdorura. I njëjti do të jetë i locuar në objekt të ndërtuar posaçërisht për këtë i cili mund të funksionojë normalisht gjatë gjithë vitit. Ekziston edhe nevoja për shitje-tregëti dhe prodhime të automjeteve motorike, të cilët kanë qenë gjithashtu objekt i tregëtisë. Në të njëjtën kohë do të përmirësohet edhe pamja urbane e vendeve të parashikuara për këtë lloj shitjeje, meqenëse në këtë moment tregu i njëjtë i tillë shëmton pamjen urbane të komunës dhe qytetit. Gjithashtu, organizimi i një tregu të tillë të specializuar do të japë efekte pozitive dhe për zhvillimin ekonomik lokal.	
Rezultate të pritura : - Treg komunal i specializuar i ndërtuar - Punësime të reja - Efekte pozitive për zhvillimin ekonomik lokal - Realizimi i të ardhurave për komunën dhe Qytetin e Shkupit - Marrje e hapësirës së organizuar dhe urbane - Kontroll i shitjes	Grupe target: - Persona të papunësuar - Vetëqeverisje lokale - Tregëtarë individualë - Inspeksion - Pronarë të ndërmarrjeve të vogla
Palë të interesuara të mundshme - Qyteti i Shkupit - Komuna Gazi Baba - Sektori privat (biznes)	Faktorë hyrës: - Dokumentacion, projekte - Financa - Njerëz - Pajisje
Indikatorë: - Treg i ri i organizuar - Persona të angazhuar në mënyrë plotësuese - Rritje e të ardhurave komunale	Data e fillimit: 2007 Kohëzgjatje: 2 vjet
Buxhet i parashikuar: 20.000 Euro Burime të financimit: Buxhet i komunës: 16.000 евра Qyteti i Shkupit: 4.000 евра Qeveria _____, Donatorë _____ Kredi/Letra me vlerë _____	

Projekti nr 1.2 Projekti: Treg me pakicë i organizuar në komunën Shuto Orizari	Sfera: tregëti Qëllimi strategjik: Sigurim i kulaitetit dhe standartit të lartë të jetesës së qytetarëve dhe ambient tërheqës për bizneset, banorët dhe turistët
Përshkrim i shkurtër i projektit: <p>Në të gjitha tregjet e deritanishme të organizuara në Qytetin e Shkupit, nevoja imponoi, përveç tregëtisë me pakicë të prodhimeve bujqësore të shiten prodhime nga më të ndryshmet tregëtare e artizanale, që solli deri në mbingarkimin e të njëjtave. Tregjet e gjelbra, nga njëra anë, janë të mbingarkuara dhe jofunksionale dhe zënë një sipërfaqe të madhe. Hapësira e ngushtuar e qytetit nuk jep mundësi për zgjerimin e tyre, dhe në këtë mënyrë bëhet një grykë e ngushtë për zhvillimin e tyre.</p> <p>Nga ana tjetër ekziston nevojë reale për treg të organizuar për të gjitha mallrat e përdorur dhe prodhimet artizanale.</p> <p>Ekziston edhe mundësia për shitje-tregëti të prodhimeve second-hands (të përdorur) për ekonomitë shtëpiake, si mobilje, aparate elektrike, etj që do të jenë gjithashtu objekt i tregëtisë.</p> <p>Titullari mund të jetë ndërmarrje e komunës publike e formuar për këtë qëllim, ose t'i jepet subjekti tjetër të interesuar që merret me atë problematikë.</p> <p>Në fund, me punën dhe me tregun e gjelbër të çliruar dhe me tregun e ri të organizuar të përmirësohet buxheti i komunës dhe Qytetit të Shkupit</p>	
Rezultate të pritura: <ul style="list-style-type: none"> - Burime të të ardhurave për Qytetin dhe komunën - Tregu i gjelbër i organizuar në komunë të merret me tregëti të prodhimeve bujqësore - Çlirimi i rrugës kryesore në komunë për zhvillimin normal të komunikacionit - Formimi i ndërmarrjes publike të komunës për këtë qëllim 	Grupe target: <ul style="list-style-type: none"> - Zejtarë - Firma tregëtare dhe individë tregëtarë - Subjekte të tjera në tregëti që nuk kanë origjinë bujqësore
Palë të interesuara të mundshme: <ul style="list-style-type: none"> - Qyteti Shkupit - Komuna Shuto Orizari 	Faktorë hyrës: <ul style="list-style-type: none"> - Pajisje - Njerëz - Trajnim dhe financime
Indikatorë: <ul style="list-style-type: none"> - Treg i gjelbër i çliruar dhe treg i ri i formuar dhe i organizuar - Përmirësimi i buxhetit të komunës 	Data e fillimit: 2007 Kohëzgjatje: 2 vjet
Buxhet i parashikuar: 20.000 Евра Burime të financimit: Buxhet i Qytetit të Shkupit 4.000 евра Buxhet i komunës 16.000 евра, Qeveria _____, Donatorë _____ Kredi/Letra me vlerë _____	

Projekti nr: 1.3	Sfera: tregëti Qëllimi strategjik: Sigurim i kulaitetit dhe standartit të lartë të jetesës së qytetarëve dhe ambient tërheqës për bizneset, banorët dhe turistët
Projekti: Treg i organizuar në komunën Çair për tregëti me pakicë me dru të përpunuar, material ndërtimi të përpunuar, makineri dhe vegla për përpunimin e mat. ndërtimit.	
Përshkrim i shkurtër i projektit: Organizimi i tregut në komunën Çair për tregëti me pakicë me dru të përpunuar, material ndërtimi të përpunuar, makineri dhe vegla për përpunimin e materialeve të ndërtimit, është shumë e nevojshme për komunën dhe Qytetin e Shkupit. Me këtë do të përmirësohet pamja urbane e vendeve të parashikuara për këtë lloj tregëtie. Gjithashtu, organizimi i një tregu të tillë do të japë efekte pozitive edhe për zhvillimin ekonomik lokal.	
Rezultate të pritura: - Hapësirë e organizuar dhe urbanizuar e përfunduar - Hapja e vendeve të reja të punës - Realizimi i të ardhurave për komunën - Efekte pozitive për zhvillimin ekonomik lokal - Kontrolli i shitjes	Grupe target: - Persona të papunësuar - Vetëqeverisje lokale - Tregëtarë individë - Pronarë të ndërmarrjeve të vogla - Inspeksion
Palë të interesuara të mundshme: - Qyteti i Shkupit - Komuna Çair	Faktorë hyrës: - Financa - Njerëz - pajisje
Indikatorë: - Treg i ri i organizuar - Persona të angazhuar në mënyrë plotësuese	Data e fillimit: 2007. Kohëzgjatje: 2 vjet
Buxhet i parashikuar: 20.000 evra Burime të financimit: Buxhet i komunës: 16.000 evra Qyteti i Shkupit: 4.000 evra Qeveria _____, Donatorë _____ Kredi/Letra me vlerë	

Projekti nr: 1.4	Sfera: Qëllimi strategjik: 1 Sigurim i kulaitetit dhe standartit të lartë të jetesës së qytetarëve dhe ambient tërheqës për bizneset, banorët dhe turistët
Projekti: “Definimi i ofertës në pjesën e monumenteve natyrore, arkeologjike dhe kulturore”	
Përshkrim i shkurtër i projektit: Definimi i ofertës në pjesën e monumenteve ekzistuese natyrore, arkeologjike dhe kulturore përbën një hap të rëndësishëm në përpjekjet e çdo vetëqeverisjeje lokale të japë kontribut në zhvillimin ekonomik lokal, me qëllim zvogëlimin shkallës së papunësisë në nivel lokal nëpërmjet afirmimit dhe popullarizimit të potencialeve ekzistuese. Në territorin e komunës Gjorçe Petrov, deri tani janë locuar lokalitetet e mëposhtme që premtojnë një ofertë të pasur dhe pjellore: Golema kulla, Dupçe, Ushi, Crkvishte, Devojački kamen; Në pjesën rurale të komunës ekzistojnë ekzistojnë një numër i madh kishash dhe manastiresh, nga të cilat me grandiozitetin e tij veçohet kompleksi i manastireve Shën. Gjorgjija dhe f. Kuçkovo. Për definimin e ofertës së pari janë të nevojshme inpute si: lokacione të definuar, të pastruara	

dhe të rregulluara nga ana infrastrukturore, kuadro profesionalë për planifikimin e ofertës, si dhe informacione, njohuri dhe menaxhim me procesin e përgatitjes së ofertës;	
Rezultate të pritura: - Definimi i lokacioneve të mundshme arkeologjike, dhe monumenteve kulturore dhe natyrore - Trajnimi i popullatës; - Zvogëlimi i shkallës së papunësisë në nivel lokal; - Rritja e XHDP në nivel lokal; - Punësime të reja; - Vetëdije e ngritur e popullatës nëpërmjet bashkëpunimit e popullatës nga pjesa rurale me komunat e vëllazëruara dhe bartje të eksperiencave pozitive në pjesën e ofertës turistike;	Grupe target: - Popullsia që momentalisht merret me bujqësi; - Populsi e papunësuar në pjesët rurale të komunës;
Palë të interesuara të mundshme:	Faktorë hyrës:
Bashkësia	Përkrahje themelore, edukimi i popullsisë, përkrahje teknike dhe administrative;
Spektori i biznesit	Përkrahje financiare
Donatorë	Përkrahje financiare
Qyteti i Shkupit	Përkrahje financiare, teknike dhe administrative, informacione;
Indikatorë: - Numri i familjeve fshatare; - Numri i vizitorëve të lokacioneve lëndore; - Numri i qytetarëve të informuar; - Fitim i realizuar, lartësia e investimit; - Punësime të reja; - Buxhet i siguruar rreth 30.000€;	Data e fillimit: Tetor, 2007; Kohëzgjatje: 1 vit;
Buxhet i parashikuar: 30.000 € Burime të financimit: Buxhet i komunës: 9.000 euro Spektori privat ____ / ____, Qeveria ____ / ____, Donatorë 21.000 euro	

Projekti nr 1.6	Sfera: Turizëm
Projekti: Promovim turistik i objekteve speleontologjike-shpellat Ubava dhe Vrelo	Qëllim strategjik: Sigurim i kulaitetit dhe standartit të lartë të jetesës së qytetarëve dhe ambient tërheqës për bizneset, banorët dhe turistët
Përshkrim i shkurtër i projektit:	
<p>Qëllimi kryesor i këtij projekti është të rregullohen objekte speleontologjike-shpellat që gjenden në Kanioni Matka, që me bukurinë e pasurinë e tyre të formacioneve dhe mineraleve përbëjnë një atraksion të vërtetë dhe tërheqjen e vëmendjes të turistëve vendas dhe të huaj dhe vizitorë dhe gjallërimin e qendrës rekreative –turistike Matka.</p> <p>Me këtë projekt mundësohet që të vizitohen shpellat, nëpërmjet ndërtimit të korsisë së re nga njëra anë e shpellës deri në tjetrën dhe riparim, përkatësisht rregullim të asaj ekzistuese, nëpërmjet vendosjes së parrakëve të sigurimit dhe rrjetës që do të mbrojnë nga shembjet dhe pasoja të padëshirueshme, më tej vizitë në shpella me barkë, ndriçim i shpellave, sigurim i udhëheqësit turistik, i cili do t'i njohë turistët me bukurinë e shpellave dhe me bukurinë dhe mundësitë për sporte të ndryshme që ofron Matka.</p> <p>Më tej, përgatitje e materialit propogandistiko-turistik për promovimin e kanionit dhe shpellave.</p>	

Rezultatet e pritura : 1. Shpella të rregulluara –ndriçuara 2. Korsi të rregulluara për këmbësorë, gjegjësisht të sigurta 3. Udhëheqës turistikë 4. Material turistik propagandues për promovimin e tyre	Target grupet: 1. Turistë të vendit dhe të huaj 2. Speleologë të vendit dhe të huaj 3. Banorët përreth
Palë të interesuara të mundshme: 1. Qyteti i Shkupit 2. Shoqata speleologjike Peoni 3. Qendra për aftësim profesional Federata për sporte alpiniste e Maqedonisë 4. Agjencia për të rinjë dhe sport	Faktorë hyrës: Financa Trajnim Njerëz Pajisje Ekspertë Informacione
Indikatorë: 1. Krijimi i parkut speleologjik bashkëkohor, përkatësisht shpellë e rregulluar 2. Qendër rekreative e revitalizuar tur. Matka 3. Numër i ritur i vizitorëve dhe turistëve (të vendit dhe të huaj) 4. Ritje e derdhjeve financiare 5. Punësime të reja.	Data e fillimit: 2007 Kohëzgjatja: 2 vjet
Buxheti i paraparë: 25.000 Euro Burimet e financimit: Buxheti i komunës: Qyteti i Shkupit 5.000 euro Qeveria: Donatorë: 20.000 euro Kredi/Letra me vlerë	

Projekti nr. 1.7	Fusha: Turizëm
Projekt: Lokaliteti alpinist Matka – rregullim i drejtimeve alpinistike dhe vendosja e pikave bashkëkohore të sigurisë dhe tabelave informative	Qëllimi strategjik: Sigurim i kualitetit dhe standardit të lartë të jetesës së qytetarëve dhe ambient tërheqës për bizneset, banorët dhe turistët
Përshkrim i shkurtër i projektit: Lënda kryesore e aktivitetit projektues është prezantimi i lokalitetit alpinist Matka si objekt turistik. Veçanërisht është e rëndësishme të potencohen mundësitë e lokalitetit në fushën e zhvillimit të turizmit avanturistik bashkëkohor në qytetin e Shkupit. Mikroklima specifike mundëson që intenzivisht të ngjiten drejtimet alpinistike në shkëmbinjtë përgjatë gjithë vitit, dhe për këtë shkak është shumë interesant si objekt për trajnim, përgatitje dhe turizëm alternativ alpinist. Veçoritë natyrore, së bashku me numrin e madh të monumenteve kulturore-historike tërheqin një numër të madh të turistëve të vendit dhe të huaj dhe dashamirë të sportit dhe rekreimit. Me rregullim të mirë të drejtimeve alpiniste dhe sigurimit të pykave të sigurta, hapet mundësi ata të ofrohen për punë me turistë, të cilët janë të interesuar për turizëm alternativ alpinistik.	
Rezultatet e pritura : 1. Drejtime të ndërtuara alpinistike dhe vendosje e pikave bashkëkohore të sigurisë dhe tabelave informative. 2. Promovim i lokalitetit turistik – rekreativ Matka dhe ritjen e numrit të turistëve 3. Përpilim i materialit të shtypur dhe video materialit për lokalitetin alpinistik.	Target grupe: 1. Qytetarët e Shkupit 2. Banorët e vendbanimeve përreth 3. Mysafirë të vendit dhe të huaj 4. Të rinjtë e Qytetit – nxënës dhe studentë. 5. Alpinist të vendit dhe të huaj dhe alpinist sportiv.

<p>4.Hapjes të vendeve të reja të punës, veçanërisht për punëtorët sportiv – instruktorë për trajnim të sporteve të reja - ngjitës</p> <p>5.Hapja e vendeve të reja të punës, veçanërisht për banorët përreth</p>	
<p>Palë të interesuara të mundshme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Qyteti i Shkupit 2. Qendra për aftësim profesional pran Federatës të sprteve alpiniste të Maqedonisë 3. Organet e asociacionit ndërkombëtar me shërbim profesional për shpëtim nga R. e Maqedonisë 4. Agjencia për të rinjë dhe sport 	<p>Faktorë hyrës:</p> <p>Financa Trajnim Njerëz Pajisje Ekspertë Informacione</p>
<p>Indikatorë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Krijim i qendrës alpinistike bashkëkohore të rangut botëror 2. Alpinist të trajnuar 3. Numër i ritur i vizitorëve të huaj dhe të vendit 4. Ritje e derdhjeve financiare 5. Punësime të reja. 	<p>Data e fillimit: 2007</p> <p>Kohëzgjatja: 3 vjet</p>
<p>Buxheti i paraparë: 125.000 Euro</p> <p>Burimet e financimit:</p> <p>Buxheti i komunës: 5.000 euro Qyteti i Shkupit: 50.000 euro Donatorë: 50.000 euro Kredi/Letra me vlerë: 20.000 euro</p>	

Projekti nr. 1.8	Fusha: Turizëm
Projekti: Revitalizim të Akuaduktit si monument kulturor historik dhe afirmim i tij	Qëllimi strategjik: Sigurim të kualitetit dhe standardit të lartë të jetës të qytetarëve dhe mjedis tërheqës për bizneset, banorët dhe turistët
Përshkrim i shkurtër i projektit: Revitalizim i Akuaduktit, restaurim i ri, rregullim infrastrukturor i hapësirës rreth akuaduktit, ndërtim i rrugëve, ndriçim. Kreftim i manifestimeve kulturore, zbavitjeve, promovimeve...	
Rezultatet e pritura: <ul style="list-style-type: none"> • Gjallërim i Akuaduktit • Ritje ekonomike • Ritje e turizmit • Ambient i pastër • Infrastrkturë adekuatë 	Target grupe: <ul style="list-style-type: none"> • Qytetarët • Vizitorë të vendit dhe të huaj
Palë të interesuara të mundshme: <ul style="list-style-type: none"> • LE • Qyteti i Shkupit 	Faktorë hyrës :
Indikatorë: <ul style="list-style-type: none"> • Ritje të të ardhurave • Ritje e numrit të manifestimeve kulturore • Ritje e numrit të turistëve 	Data e fillimit: Kohëzgjatja: 2007-2009
Buxheti i paraparë: Burimet e financimit: Buxheti i komunës: Spektori privat: Qeveria: Donatorë: Kredi/Letra me vlerë:	

Projekti nr: 1.11	Fusha: Turizëm Qëllimi strategjik: 1
Projekti: Vendosje e tabelave informative, infokioskave dhe panove informative elektronike	Sigurim të kualitetit dhe standardit të lartë të jetesës dhe mjedis tërheqës për bizneset, banorët dhe turistët
Përshkrim i shkurtër i projektit: Vendosje e sistemit të ri, bashkëkohor dhe të sofistikuar për informimin e qytetarëve, vizitorëve dhe turistëve, me vendosjen e tabelave informative, kioskave dhe panove elektronike, në të cilat krahas simbolit të komunës, do të vendoset hartë më shenja për të gjitha monumentet kulturore – historike, objekte të rëndësishme afariste, kapacitete vendosëse, oferta hotelierike, ngjarje, bukuri natyrore si mundësi për lloje të ndryshme të turizmit. Krahas shenjave për vendndodhjen me këto pano dhe kioska do të mundësohen informacione, promovim turistik i qytetit të Shkupit, gjindje dhe informim me i mirë hapsnior, e me këtë dhe tërheqje e vizitorëve dhe turistëve.	
Rezultatet e pritura : 1. Qasje më e madhe e informacioneve të ndryshme për monumentet kulturore – historike dhe objekteve tjera në Shkup 2. Numër i ritur i turistëve 3. Ritje e të ardhurave 4. Ritje e interesit dhe vetëdijes së qytetarëve për llojet specifike të turizmit dhe afirmim i objekteve dhe lokaliteteve më pak të njohura 5. Mundësi më e madhe për prezentim të resurseve turistike, afariste dhe të gjitha resurseve tjera	Target grupe: 1. Turistë dhe vizitorë të vendit dhe të huaj 2. Qytetarët e qytetit 3. Pjesëmarrës në seminare të ndryshme, ekskurziona shkencore
Palë të interesuara të mundshme: 1. Qytetit i Shkupit 2. TI - shërbimet 3. Organizatat afariste, hotelierike dhe turistike 4. Institucionet shkencore, të arsimit, shëndetësore e tj.	Faktorë hyrës: 1. Financa 2. Trajnim 3. Njerëz – udhëheqës me panotë elektronike (azhurim) 4. Pajisje 5. Ekspertë 6. Informacione
Indikatorë 1. Vendosje të info – panove, kioskave dhe info - panove elektronike 2. Qasje të shpejtë deri te informacionet e nevojshme për turistë dhe qasje më e shpejtë deri te lokalitetet 3. Ritje e numrit të turistëve 4. Ritje e të ardhurave nga turistët	Data e fillimit: 2008 Kohëzgjatja: 2 vjet
Buxheti i paraparë: 40.000 Euro Burimet e financimit: Buxhet i komunës: Qyteti i Shkupit: 5.000 euro, Donatorë: 35.000 euro	

Projekti nr. 1.12.		Fusha: Kthim të artizanatit në Çarshinë e Vjetër të Shkupit	
Projekti: Revitalizim i Çarshisë të Vjetër të Shkupit		Qëllimi strategjik: Sigurim të kualitetit dhe standardit të lartë të jetesës së qytetarëve dhe mjedis tërheqës për bizneset, banorët dhe turistët	
Përshkrim i shkurtër i projektit: Me projektin "Revitalizim i Çarshisë të Vjetër të Shkupit" ka për qëllim ndërmarrjen e masave të nevojshme konkrete për pasurimin dhe gjallërimin e Çarshisë të Vjetër të Shkupit. Ajo nënkupton sigurimin e fondit me të cilin do të mbulohen qiratë për hapësirë afariste të artizanateve të vjetra të cilat po vdesin ose kanë vdekur, lirim nga tatimet dhe kontributet dhe të vendosen në ofertat turistike të Qytetit të Shkupit, nga e cila do të sigurohen të ardhura dhe do të shërbejnë për atraktivitet dhe promovim të traditës dhe kulturës tonë. Kthimin e rrugëve me përmbajtje, si e jorganxhive, argjentare, filigrane, artzanate të vjetra tradicionale, të papuçeve të saraçëve, të çantave. Të silltet Ligji për Çarshinë e vjetër të Shkupit me të cilin do të parashikohet se në dyqane mund të kryhen vetëm veprimtari artizanati, dhe nuk mund të kryhet qarrkullim. Sigurimi i kushteve dhe klimës të volitshme për fillimin e veprimtari të artizanatit të cilat e bashkojnë të vjetrën, tradicionale me të rene, moderne. Ndërmarrja e masave për përmirësimin e kualitetit të ofertës të prodhimeve dhe mallrave të vjetra tradicionale. Përgatitjen e rregullave të sjelljes të zanatçinjëve, për enterierin e jashtëm, qese dhe paketime të prodhimeve me të cilën do të kontribohet drejt formimit të brendit të fortë dhe unik të Çarshisë të Vjetër të Shkupit. Dobia e artizanatit edhe atë krijimeve të vendit dhe artistike, zanateve hotelierike, brumrave dhe ëmbëlsirave do të kontribojë për paraqitje më të mirë të kulturës dhe kuzhinës tonë multi-etnike. Krahas kësaj do të ndërmeren edhe masa tjera me qëllim të ruajtjes së asaj që është me vlerë, e cila njëherësh do të japë kontribut drejt zhvillimit ekonomik lokal.			
Rezultatet e pritura :		Target grupet:	
<ul style="list-style-type: none"> • Gjallërim dhe kultivim të zanateve të vjetra, të vdekura tradicionale (samarxhi, thurës, tjerës); • Ritje të shitjes, nëpërmes përmirësimit të imixhit dhe kualitetit të prodhimeve si dhe kualitetin e ofertës; • Ofertë turistike e pasuruar nëpërmes vendosjes së artizanatit si brend dhe simbol të njohur • Nxitje të vetëpunësimit si mënyrë për zvogëlimin e papunësisë; • Gjallërim të Çarshisë të vjetër të Shkupit; 		Zanatçinjtë në R. e Maqedonisë . <ol style="list-style-type: none"> 1. Zanatet e vjetra të cilat po vdesin; 2. Zanate të vjetra të cilat e bashkojnë të vjetrën, tradicionale me të rene, bashkëkohore; 3. Zanate me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik; 4. Zanate nga fusha e hotelierisë, brumrave, ëmbëlsirave të cilat do të prodhojnë prodhime tradicionale 	
Palët e mundshme të involvuara (subjekte)		Inpute (kryerës të brendshëm):	
Qyteti i Shkupit me Komunat	Përkrahje, informacione teknike dhe administratve, përkrahje financiare, ekspertizë		
Biznes sektori dyqanat e artizanatit	Përkrahje financiare, hapësirë për bashkëpunim		
Ndërmarrjet publike	Shërbime publike dhe komunale		
Ministritë dhe agjencitë qeveritare	Përkrahje teknike, administrative dhe organizative		
Organizatat joqeveritare	Përkrahje dhe informacione teknike, administratve dhe organizative		
Financier/investues	Përkrahje financiare		
Indikatorë:		Data e fillimit:	
